

## **Kontrolli i Lartë i Shtetit merr pjesë në tryezën e diskutimit “Rritja e përgjegjshmërisë së Parlamentit ndaj shqetësimeve të qytetarëve”**

Me ftesë të Institutit Shqiptar të Shkencës (AIS), në datën 01.03.2024, Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) mori pjesë në tryezën e diskutimit me temë “Rritja e përgjegjshmërisë së Parlamentit ndaj shqetësimeve të qytetarëve”, ku ishin të pranishëm përfaqësues të Kuvendit të Shqipërisë, si dhe ekspertë të financave publike, ligjor etj.

KLSH u përfaqësua në këtë takim nga drejtorja e Departamentit të Metodologjisë, Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit Profesional, znj. Aulona Jani, znj. Krisela Ngjela dhe znj. Mirela Vasili, audituese pranë Departamentit të Auditimit të Buxhetit të Shtetit, dhe znj. Jonida Tashi, specialiste në Drejtorinë e Komunikimit, Botimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë në KLSH.



Znj. Aranita Brahaj, drejtoreshë ekzekutive e AIS, gjatë prezantimit të saj në këtë takim theksoi rëndësinë që ka monitorimi i buxhetit të shtetit dhe shpenzimeve publike përmes instrumenteve inovative, databazave dhe platformave, si: “Të dhëna të hapura/ Open Spending” dhe “Buxhet i hapur/ Open Budget”.



Fokusi kryesor i diskutimeve në tryezë ishte “Mbikëqyrja parlamentare e financave publike dhe Kontrolli i Lartë i Shtetit”, ku sipas ekspertëve nevojitet forcimi i rolit të Parlamentit, bashkëpunimit të tij me institucionet e pavaruara apo aktorë të tjerë civilë në përmirësimin e proceseve të hartimit, konsultimit dhe monitorimit të buxhetit shtetëror dhe financave publike. Bazuar në kuadrin ligjor dhe parimet e standardeve ndërkombëtare të auditimit, institucioni i auditimit të jashtëm publik ndihmon Parlamentin të kontrollojë qeverinë, duke vepruar si ofrues shërbimesh dhe “kujdestar” i pavarur i interesave të qytetarëve.

Në takim u evidentua nevoja e ngritjes dhe funksionimit të një komisioni të veçantë dhe të përhershëm apo nënkomisioni si pjesë e Komisionit të Ekonomisë dhe Financave, si një nga

mjetet për të rritur dhe përmirësuar mbikëqyrjen e aktivitetit financiar të qeverisë, duke shqyrtuar në mënyrë periodike raportet e auditimit të KLSH-së.

Gjithashtu, bazuar në praktikat e vendeve të tjera, u vlerësua me interes pjesëmarrja aktive e shoqërisë civile në procesin e miratimit të buxhetit të shtetit në Parlament.